



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2916 / Prot.

2

Tiranë, më 22/12 /2022

VENDIM

Nr. 26, datë 22.12.2022

PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI NDËRTIMI, ME NËNFUSHË INXHINIERI NDËRTIMI NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, NË UPT

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.12.2022,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Inxhinieri Ndërtimi, me nënfushë Inxhinieri Ndërtimi, dhe miratimin e tre projekteve kërkimore-shkencore në "Analiza e strukturave të përbëra (çelik-beton)", "Sjellja e kolonave prej betoni të armuar me shufra GFRP dhe me agregat nga betoni i ricikluar" dhe "Vlerësimi i fenomeneve negative të dherave nga provat e terrenit (CPT, SPT) dhe krahasimi me rezultatet e investigimeve klasike-Porti i Durrësit dhe i Vlorës", në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari